



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 203, Datë 21.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2037/2 prot., datë 17.07.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” shpk për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2037/1 prot., datë 09.07.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse. Nga dokumentacioni i depozituar në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se objekti i këtij aplikimi lidhet me modifikimin e Aneksit A të Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, me qëllim pasqyrimin e rritjes së kapacitetit të instaluar të centralit nga 50 MW në 100 MW, si dhe shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038/1 prot., datë 13.07.2026, shoqëria ka saktësuar objektin e kërkesës, duke kërkuar përfshirjen në Aneksin A të licencës të sistemit të depozitimit të energjisë (BESS) me kapacitet të instaluar 200 MW, duke sqaruar se sistemi BESS synon të krijojë një mekanizëm fleksibiliteti që mundëson absorbimin e tepricave të prodhimit të parqeve fotovoltaik të projekteve BLUE, me qëllim uljen e disbalancave të shkaktuara nga gjenerimi.
- Po ashtu, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e saj të datës 30.06.2026, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

(MIE), me anë të së cilës njofton mbi ndërtimin e sistemeve depozituese për një kapacitet 200 MW, duke theksuar se instalimi i këtij sistemi nuk ndryshon kapacitetin maksimal të injehtimit në rrjet.

- Për sa kërkuar nga shoqëria në lidhje me veprat ndihmëse, sjellim në vëmendje se në shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1291/8 prot., datë 01.07.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka sjellë në vëmendje të ERE-s se: *referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi.*
- Si e tillë, vlerësohet që për sa kërkuar nga shoqëria për të përfshirë në licencën e prodhimit dhe veprat ndihmëse, t'i kërkohej asaj qëndrimi/vlerësimi i MIE-s. Po ashtu, vetë ERE do të njoftojë MIE-n në kuadër të kësaj procedure.
- Rezulton se me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 19.06.2026 “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50MW, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse dhe veprave ndihmëse në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruktion” sh.p.k.”, është miratuar ndryshimi i kapacitetit të instaluar të centralit nga 50 MW në 100 MW. Duke qenë se kjo VKM ngarkon MIE-n dhe shoqërinë për ndjekjen e zbatimit të tij, si dhe në referencë të Kontratës nr. 2721 Rep., nr. 2067 Kol., datë 09.07.2021, të nënshkruar më herët me MIE-n, vlerësohet se shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e Kontratës ku të jenë pasqyruar këto ndryshime.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e Rregullores, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (c, e, dhe f).
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë sa vijon:

Neni 15, “Modifikimi i Licencës”

Pika 4,

- **gërma “a”:** Autorizimin përkatës për përfaqësuesin e saj, që ka nënshkruar shkresën e protokolluar në ERE nr. 2038/1 prot., datë 13.07.2026.
- **gërma “b”:** Sqarimet përkatëse në lidhje me mënyrën e karikimit për kapacitetin e kërkuar prej saj, pasi nuk është e qartë nëse është vetëm për nevojat e vetë të licencuarit “SPV Blue 2” apo dhe të impianteve fotovoltaike të të licencuarve të tjerë, si dhe informacion shtesë mbi mënyrën se si parashikon financimin e këtyre ndryshimeve.
- **gërma “g”:** Miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., si dhe sqarimet përkatëse në lidhje me kapacitetin, për të cilin ka marrë opinion paraprak.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe OST sh.a.
- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha

- kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.
- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, për rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 MW në 100 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ANËTAR I BORDIT

Petra LIKA